



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1469, datë 24.12. 2010**

**Për**

**“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.12.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT

## **BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 58 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (**VKD**) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Vendimet nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, date 31.03.2010, të ndryshuara, për shpalljen me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile;

## **K Ë SHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## **V Ë R E N:**

1. AKEP me vendimet nr.1210, nr.1211 dhe nr.1212, date 31.03.2010, të ndryshuara, për shpalljen me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, ka përcaktuar se orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT në tregjet përkates do të kryhet sipas përcaktimeve të vendimeve të veçanta të AKEP, të marra pas një konsultimi publik sipas nenit 58, pika 1 e ligjit 9918.
2. Drejtoria e rregullimit ekonomik ka përgatitur dokumentin “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”, i cili bazohet në rezultatet përfundimtare të Modelit BULRAIC të kostove telefonike të operatorëve celularë, të përgatitur nga kompania konsulente ICC.
3. Këshillimi publik do të kryhet për marrjen e vendimeve të AKEP për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT në tregjet përkates, vendime të cilat janë të rëndësishme dhe me interes për të gjithë tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësine e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Orientimi në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”.
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet nga data 29.12.2010 deri më 29.01.2011.
3. Ky vendim dhe dokumenti “Orientimi në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT” të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **A N Ë T A R Ë:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**